



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

P. nr.698/2018

### NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Rrahman Beqiri, me procesmbajtëse Selvije Kostërci, në lëndën penale ndaj të pandehurve: V.M. dhe S.K., për shkak të veprës penale: Vjedhje në bashkëkryerje në vazhdim, të parashikuar nën 325 par. 1 e lidhur me nenin 31 dhe 8 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.868/2018 të datës 31.08.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 20.02.2019 në prezencën e Prokurorit të Shtetit Jovo Radovic dhe të pandehurve, me datë 25.02.2019 publikisht shpalli, ndërsa me datë 12.03.2019 përpiloi këtë:

### A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

I. V.M., nga i ati ... dhe e ëma ..., e vajzërisë ..., i lindur me datë ... në ..., tani me vendbanim në adresën: Rr. “...” Komuna ..., i pa martuar, punon si kamarier, i gjendjes së dobët ekonomike, ka të kryer shkollën fillore, me nr. personal ..., shqiptar, shtetas i Kosovës.

II. S.K., nga i ati ... dhe e ëma ..., e vajzërisë ..., i lindur me datë ... në ..., komuna e ..., ku edhe jeton, në adresën: Rr. “...” Komuna ..., i pa martuar, punon si kamarier, i gjendjes së dobët ekonomike, ka të kryer shkollën fillore, me nr. personal ..., shqiptar, shtetas i Kosovës.

### JANË FAJTORË

Sepse,

Nga data 26.09.2016 e deri me datë 29.09.2016, sëbashku dhe me marrëveshje paraprake, kanë marrë pasurinë e personave tjerë në vlerë prej më shumë se 50 euro, e me qëllim të përfitimit për vete, në atë mënyrë që:

- Me datën 26/27.09.2016 kanë shkuar në Rr. “...” në ... dhe nga makina e llojit “Passat”, me targa të regjistrimit ..., pronë e të dëmtuarit H.F., e cila ka qenë e parkuar në rrugën e cekur, e kanë hjekur masken plastike dhe me masken plastike janë larguar nga vendi i ngjarjes.
- Me datën 27/28.09.2019 kanë shkuar në Rr. “...” në ... dhe nga pjesa e përparme e makinës së llojit “Passat”, me targa të regjistrimit ..., pronë e të dëmtuarit R.B., e cila ka qenë e parkuar në rrugën e cekur, e kanë hjekur masken plastike dhe me masken plastike në fjalë janë larguar nga vendi i ngjarjes.
- Me datën 27/28.09.2019 kanë shkuar në Rr. “...” në ... afër autoshkollës “...” dhe nga pjesa e përparme e makinës, pronë e të dëmtuarit V.S., e cila ka qenë e parkuar në rrugën e cekur, e kanë hjekur masken plastike dhe me masken plastike në fjalë janë larguar nga vendi i ngjarjes.

- Me datën 27/28.09.2019 kanë shkuar në Rr. “...” në ..., afër stacionit të autobusëve dhe nga pjesa e përparme e makinës së llojit “Passat 3c”, ngjyrë hiri, me targa të regjistrimit ..., pronë e të dëmtuarit M.K., e cila ka qenë e parkuar në rrugën e cekur, i kanë hjekur dy maska të plastikës (grillat) dhe me maskat plastike në fjalë janë larguar nga vendi i ngjarjes.
- Me datën 28/29.09.2019 kanë shkuar në Rr. “...” në ..., afër autoshkollës “...” dhe në parking, dhe nga makina e llojit “Golf 4”, pronë e të dëmtuarit ..., i kanë hjekur dy masak plastike nga pjesa e përparme e makinës dhe me to janë larguar nga vendi i ngjarjes.
- Me datën 28/29.09.2019 kanë shkuar te makina e llojit “VW Golf” pronë e të dëmtuarit S.H., e cila ka qenë e parkuar në Rr. “...” në ..., afër banesës ku i dëmtuari jeton, dhe nga pjesa e përparme e makinës e kanë hjekur masken plastike dhe me të njëjtën janë larguar nga vendi i ngjarjes.
- Me datën 28/29.09.2019 kanë shkuar në Rr. “...” në ... dhe nga makina e llojit “VW Golf 4”, me targa të regjistrimit ..., pronë e të dëmtuarit B.F., e cila ka qenë e parkuar në rrugën e cekur, e kanë hjekur dy maska plastike dhe me maskat në fjalë janë larguar nga vendi i ngjarjes.
- Me datën 29.09.2019 kanë shkuar në Rr. “...” në ... dhe nga pjesa e përparme e makinës së llojit “Passat”, me targa të regjistrimit ..., pronë e të dëmtuarit E.H., e cila ka qenë e parkuar në rrugën e cekur, i kanë hjekur dy maska plastike dhe me maskat në fjalë janë larguar nga vendi i ngjarjes.

Me këtë kanë kryer veprën penale: Vjedhje në bashkëkryerje në vazhdim nga neni 325 par.1 e lidhur me nenin 31 dhe 81 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në bazë të nenit 4, 7, 17, 21, 31, 41, 42, 43, 45, 46, 47, 73, të KPRK-së, dhe nenit 365, 450, 463 të KPP-së, të akuzuarit i:

## **G J Y K O N**

1. Me dënim me burg, secilin veç e veç, në kohëzgjatje pre gjashtë (6) muajve.
2. Me dënim me gjobë, secilin veç e veç, në shumën prej 300 € (treqind euro), të cilën gjobë janë të obliguar ta paguajnë në kohëzgjatje prej 3 muajve nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse të akuzuarit nuk e paguajnë gjobën në afatin e caktuar, gjykata do të veprojë në bazë të nenit 46 të KPRK-së, ashtuqë dënimin me gjobë mund t`ua zëvendësoj me dënim me burg, ku një ditë burgim do të llogaritet me 20 (njëzet) euro gjobë.
3. Obligohen të akuzuarit që në mënyrë solidare t`i paguajë shpenzimet e procedurës gjyqësore sipas llogarisë përfundimare të gjykatës, dhe atë në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej 30€, ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 30€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
4. Të dëmtuarit: H.F., R.B., V.S., F.K., S.H., B.F., M.K., dhe E.H., të gjithë nga ..., për realizimin e kërkesës pasurore - juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridik civil.

Gjykata, në bazë të nenit 47 të KPRK-së dhe me pëlqimin e të akuzuarve, dënimin me burg në kohëzgjatje prej 6 muajve ua zëvendëson me dënim me gjobë, ashtuqë:

5. Obligohen të akuzuarit që, secili veç e veç, të paguajnë gjobën në shumën prej 1600 € (njëmijë e gjashtëqind euro), të cilën gjobë janë të obliguar ta paguajnë në afat prej 12 (dymbëdhjetë) muajve nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe atë në 12 (dymbëdhjetë) këste të barabarta, më së largu deri me datën 5 të muajit vijues. Mundësia e pagesës me këste do të revokohet nëse personat e dënuar nuk e paguajnë këstin me kohë. Nëse të akuzuarit nuk e paguajnë gjobën në afatin e caktuar, gjykata do të veprojë në bazë të nenit 46 të KPRK-së, ashtuqë dënimin me gjobë mund t'ua zëvendësoj me dënim me burg, ku një ditë burgim do të llogaritet me 20 (njëzet) euro gjobë.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore ne Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur Aktakuzën PP.II.nr.868/2018 të datës 31.08.2018, kundër të pandehurve V.M.dhe S.K. nga ..., për shkak te veprës penale: Vjedhje në bashkëkryerje në vazhdim nga neni 325 par. 1 lidhur me nenin 31 dhe 81 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar ashtu që në këtë seancë të pandehurit e kanë pranuar fajësinë në tërësi sipas aktakuzës. I akuzuari i parë ka tutje ka theksuar se e pranoj që kam qenë i ri, poashtu në atë kohë kam përdorur alkool dhe kam qenë në varësi të tij, tani shprehi keqardhje për këto veprime, tani i jam kthyer jetës normale dhe tashmë ehd ejam punësuar, andaj i premtoj gjykatës që veprime tilla nuk do të përsëris në ardhmen. Ndërsa i akuzuari i dytë, ka deklaruar se e di që kam gabuar, tashmë kam filluar të punoj dhe se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra të tilla.

Prokurori, lidhur me pranimin e fajësisë ka dhënë mendimin se të pandehurit e pranojnë fajësinë në mënyrë vullnetare, ky pranim është në pajtim edhe me provat materiale, gjendjen faktike dhe kualifikimin ligjor të veprës penale, dhe atë pas njoftimit paraprakisht për favoret dhe disfavoret e pranimit të fajësisë nga ana e gjykatës, andaj i propozon gjykatës që ta pranojë pranimin e fajësisë nga të pandehurit dhe me rastin e shqiptimit të dënimit këtë pranim ta merr parasysht si rrethanë lehtësuese.

Gjykata, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë te cilën e kanë deklaruar të pandehuri, e në mbështetje të nenit 248 të KPP-ës, në këtë drejtim vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të pandehurit. Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit, mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykate si: Deklaratën e të dëmtuarit H.F. dhënë në polici me datë 26.09.2016; Deklaratën e të dëmtuarit R.B. dhënë në polici me datë 29.09.2016; Deklaratën e të dëmtuarit V.S. dhënë në polici me datë 29.09.2016; Deklaratën e të dëmtuarit F.K. dhënë në polici me datë 29.09.2016; Deklaratën e të dëmtuarit S.H. dhënë në polici me datë 29.09.2016; Deklaratën e të dëmtuarit B.F. dhënë në polici me datë 29.09.2016; Deklaratën e të dëmtuarit M.K. dhënë në polici me datë 29.09.2016; Deklaratën e të dëmtuarit E.H. dhënë në polici me datë 04.10.2016; Deklaratën e të akuzuarit V.M.dhënë në polici me datë 29.09.2016; Deklaratën e të akuzuarit S.K. dhënë në polici me datë 29.09.2016; Vërtetimin mbi sekuestrimin e gjëseneve të datës 29.09.2016; Vërtetimet (7) për kthimin e sendeve të datës 04.10.2016, dhe fotodokumentacioni në shkresat e lëndës. Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë e tyre dhe pranimit te fajësisë, konsiderojmë se për tej çdo dyshimi

është vërtetuar se të pandehuri, në bashkëkryerje e kanë kryer veprën penale që iu vihet në barrë.

Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurve është bërë në mënyrë vullnetare, se të pandehurit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, duke i'u tërhequr vërejtja të pandehurve se pas pranimit të fajësisë, ata nuk mund të bëjnë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, mirëpo mund të bëjnë ankesë sa i përket dënimit, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik dhe nuk ekzistojnë rrethana që e ndalojnë ndjekjen, nga këto arsye gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga të pandehurit.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë se të pandehurve dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se në veprimet e të pandehurve manifestohen të gjitha elementet e veprës penale që ngarkohen dhe me këto veprime e kanë kryer veprën penale: Vjedhje në bashkëkryerje në vazhdim nga neni 325 par. 1 lidhur me nenin 31 dhe 81 të KPRK-së, e për të cilën vepër penale është paraparë dënimi me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 73 të KPK-ës. Si rrethana rënduese ka gjetur mënyrën e kryerjes së veprës penale gjë që nga provat rezulton se të pandehurit këtë vepër e kishin kryer bashkërisht, intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, e që kjo vepër penale ka qellim të mbrojtë pronën dhe pasurinë e individit, mënyrën e veprimit që konstatohet se të njëjtit kishin vepruar natën dhe duke e shfrytëzuar situatën.

Ndërsa, si rrethanë lehtësuese gjykata e ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale, faktin se të njëjtit kanë shprehur keqardhje dhe janë penduar për ndodhjen e rastit, duke premtuar se në të ardhmen nuk do të përsërisë sjelljet e njëjta, sjellja korrekte e të pandehurve në gjykatë, faktin se të njëjtit janë punësuar si dhe faktin se në shkresat e lëndës nuk ka pasur ndonjë provë që tregon se nga viti 2016 të njëjtit dyshohen edhe për ndonjë rast tjetër për këtë lloj vepre penale, si dhe faktin se këto sende janë kthyer tek të dëmtuarit.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, Gjykata në përputhje me nenin 47 të KPRK-së si dhe në pëlqimin e të akuzuarve, dënimin me burgim prej 6 muajve, ua ka zëvendësuar me dënim me gjobë, ashtuqë të njëjtit i ka obliguar që, secili veç e veç, ta paguaj shumën prej nga 1600 euro, duke e vlerësuar se ky është një dënim i drejtë dhe i përshtatshëm, në rastin konkret ndaj të akuzuarit. Ndërsa që u ka shqiptuar edhe dënim me gjobë në shumën prej 350 euro, për secilin veç e veç, duke vlerësuar se ky është një dënim i drejtë dhe i ligjshëm.

Gjykata vlerëson se, zëvendësimi i dënimit me burg në dënim me gjobë si dhe dënimi me gjobë ndaj të pandehurve është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurve. Poashtu, gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 par 1 të KPRK-së, që ti parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Poashtu, ky dënim do të shërbejë si masë preventive që në të ardhmen të pandehuri të përmbahet nga cenimi i pasurisë së çdokujt.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450 par. 2 pika 2.6 dhe nenit 453 par.1 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e paushallit gjyqësor. Ndërsa taksa për kompensimn viktimave të krimit, në kuptim të nenit 39 par. 3 të Ligjit nr. 05/L-036 per Kompensimin e Viktimave të Krimit

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 365, 450, 453 te KPPK-ës nga arsyeje e lartcekura ka vendosur si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**  
**P.nr.698/2018, dt.12.03.2019**

Procesmbajtësja:  
Selvije Kostërci

Gjyqtari

---

Rrahman BEQIRI

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.